

URDHËR
Nr.513, datë 14.10.2011

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në:

a) “Punë sociale e avancuar” me profil në “Punë sociale në arsim”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Punë sociale e avancuar”, profili “Punë sociale në arsim”.

b) “Punë sociale e avancuar” me profil në “Punë sociale në shëndetësi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Punë sociale e avancuar”, profili “Punë sociale në shëndetësi”.

2. Programet e studimeve “Master profesional” realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.

3. Programet e studimit të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Universiteti i Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj